



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr.198, datë 12.05.2021

PËR
CAKTIMIN NË POZICION, NË MËNYRË TË PËRHERSHME, NË GJYKATËN E
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, TË GJYQTARES ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR